

# PLANIFIKIMI I PROKURIMIT

**Raport i monitorimit të 20 komunave lidhur  
me planifikimin e prokurimit të vitit 2022**

Autor: Qëndrim Arifi


Redaktore: Albulena Nrecaj

Ekipi i hulumtuesve: Diell Haxhimusa, Leorentë Alija, Valmir Ilazi

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë organizatës Iniciativa për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyrë, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të Organizatës Iniciativa për Progres. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e organizatës Iniciativa për Progres – INPO dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan.

Përkrahur nga:



## Përmbajtja

1. Lista e shkurtesave .....	4
2. Përmbledhje ekzekutive .....	5
3. Metodologjia .....	7
4. Baza ligjore për planifikim të prokurimit.....	8
5. Planifikimi i prokurimit për vitin 2022.....	9
6. Respektimi i planit përfundimtar të prokurimit.....	10
6.1.Respektimi i planit të prokurimit tek aktivitetet për furnizime.....	11
6.2.Respektimi i planit të prokurimit tek aktivitetet për shërbime dhe për punë .....	12
7. Dukuria e ndryshimeve të planeve përfundimtare të prokurimit në kundërshtim me dispozitat ligjore.....	15
8. Njësitë kërkuese dhe planifikimi i prokurimit.....	17
9. Rezultatet e anketës me njësitë kërkuese.....	18
10. Zyrtarët Përgjegjës të Prokurimit dhe planifikimi i prokurimit .....	22
11. Rezultatet e anketës me Zyrtarët Përgjegjës të Prokurimit .....	22
12. Planifikimi i prokurimit dhe punët shtesë .....	24
13. Gjetjet kryesore .....	28
14. Rekomandimet.....	30
15. Aneks I: Pesë (5) aktivitetet e para për furnizime, shërbime dhe punë të monitoruara në njëzet (20) komuna .....	32

## **I. Lista e shkurtesave**

<b>AK</b>	Autoritet Kontraktues
<b>AQP</b>	Agjencia Qendrore e Prokurimit
<b>DNKDF</b>	Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimi i Disponueshmërisë së Fondeve
<b>INPO</b>	Iniciativa për Progres
<b>KRPP</b>	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
<b>LPP</b>	Ligji për Prokurimin Publik
<b>OE</b>	Operator Ekonomik
<b>OShP</b>	Organi Shqyrtues i Prokurimit
<b>RrUOPP</b>	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik
<b>ZKA</b>	Zyrtari Kryesor Administrativ

## 2. Përmbledhje ekzekutive

Planifikimi i prokurimit është një proces shumë i rëndësishëm për secilin Autoritet Kontraktues (tutje AK), për pasojë ky proces është i rregulluar me ligj dhe akte tjera nënligjore. Si hapi i parë në prokurimin publik, planifikimi është determinues edhe i fazave tjera të prokurimit, sepse një planifikim i mirë ndikon në suksesin e AK-së për vitin përkatës, dhe e kundërta, një planifikim i dobët sjellë pasoja të paparashikueshme dhe të dëmshme për AK-në.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se nga treqind (300) aktivitete të prokurimit të përzgjedhura për monitorim në njëzet (20) komunat e fokusit, përveç komunës së Klinës, komunat tjera nuk i paraqesin të gjitha detajet e kërkuara sipas ligjit, madje as ato formale në planin përfundimtar të prokurimit. INPO ka gjetur se përveç dështimit në planifikim formal të prokurimit, AK-të nuk respektojnë apo nuk i përmbahen planifikimeve të tyre, sidomos tek lëndët e furnizimeve. Kësisoj, nga njëqind (100) aktivitete të monitoruara për furnizim, vetëm gjashtëdhjetë e gjashtë (66) prej tyre figurojnë në planin e prokurimit, pjesa tjetër janë iniciuar pa qenë fare të planifikuara. Pastaj, nga nëntëdhjetë e gjashtë (96) aktivitete të monitoruara për shërbime, vetëm shtatëdhjetë e një (71) prej tyre figurojnë në planin përfundimtar të prokurimit. Situata pothuajse e njëjtë është edhe tek aktivitete për punë, ku nga njëqind (100) aktivitete të monitoruara për punë, vetëm tetëdhjetë e dy (82) aktivitete janë iniciuar sipas planit të prokurimit, pjesa tjetër nuk figurojnë fare në plan.

Hulumtimi vë në pah se komunat kundërligjshëm dhe pa ndonjë vendim apo udhëzim nga organet kompetente janë duke ndryshuar planet përfundimtare të prokurimit. Tutje, INPO ka zhvilluar një anketë me zyrtarët përgjegjës të prokurimit dhe njësitë kërkuese në komunat e fokusit, e cila ka pasur për qëllim matjen e qëndrimeve të AK-vë rreth rolit, rëndësisë dhe përgjegjësisë së zyrtarëve në planifikimin e prokurimit, rezultatet e së cilës janë shqetësuese. Rezultatet e anketës kanë treguar se njësitë kërkuese nuk e kanë të qartë se kujt i takon përgjegjësia për planifikimin e prokurimit, 43.8% e tyre mendojnë se kjo përgjegjësi është e përbashkët në mes të ZPP-ve dhe njësisë kërkuese, po aq mendojnë se kjo përgjegjësi i takon vetëm njësisë kërkuese. Pastaj, 12.5% e njësisë kërkuese potencojnë se nuk kanë kapacitete për të planifikuar artikujt, sasitë dhe njësitë në planin përfundimtar të prokurimit, ndërsa 12.5% e tyre mendojnë se nuk është e nevojshme paraqitja e artikujve, sasive dhe njësisë tek aktivitete të prokurimit.

Duke marrë parasysh ngritjen e çmimeve të tregut, vetëm 31.3% e njësisë kërkuese në kuadër të komunave të monitoruara mendojnë se AK-ja e tyre do ta implementoj planin e prokurimit, ndërsa 56% e ZPP-ve të komunave vlerësojnë se plani përfundimtar i prokurimit i përmbush pjesërisht nevojat e komunës të cilës i përket. Përkundër kësaj vetëm 17% e ZPP-ve potencojnë se kanë marrë masa në kuadër të planifikimit të prokurimit me qëllimin që planifikimet të jenë konformë rritjes së çmimeve të tregut.

Lidhur me numrin e lartë të kontratave për punë shtesë, rezulton se gjatë vitit 2021, njëzet (20) komunat e monitoruar kanë nënshkruar njëqind e nëntëdhjetë e një (191) kontrata për punë shtesë lidhur me aktivitete për punë, ndërsa vlera e punëve shtesë është 4,541,689.99 euro. Madje, në komunën e Kamenicës, Gjakovës, Gjilanit dhe Mitrovicës së Veriut, numri i kontratave për punë shtesë e tejkalon mbi 50% numrin e kontratave të planifikuara për punë gjatë vitit 2021.

Në pyetjen e INPO-s se a janë duke e keqpërdorur AK-të mundësinë ligjore për lidhjen e kontratave për punë shtesë, vetëm 5.6% e ZPP-ve vlerësojnë se AK-të e keqpërdorin mundësinë për punë shtesë, ndërsa 11.1% të ZPP-ve theksojnë se kjo mundësi ligjore keqpërdoret ndonjëherë.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, planifikimi i prokurimit vazhdon të mbetet një ndër fazat me dobësi sistematike dhe mungesë të llogaridhënies institucionale dhe individuale të zyrtarëve të përfshirë.

INPO rekomandon që të gjitha AK-të në përgjithësi dhe komunat e fokusit në veçanti, t'i kushtojnë vëmendje të veçantë fazës së planifikimit të prokurimit, duke mos u kufizuar në respektimin e kërkesave ligjore, respektivisht në detajet e kërkuara nga Formulari B01, të hulumtojnë tregun dhe të krijojnë mekanizma të mirëfilltë të monitorimit të zbatimit të planit të prokurimit, në mënyrë që të mos devijohet në fazën e inicimit të aktivitetit të prokurimit dhe të minimizohet nevoja për lidhjen e kontratave për punë shtesë.

KRPP dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike së bashku me komunat, të organizojë trajnime të vazhdueshme për zyrtarët e përfshirë në ciklin e planifikimit të prokurimit, përmes së cilave ngriten kapacitetet profesionale të zyrtarëve, në mënyrë që të ngritet edhe vetëdija e njësisve kërkuese dhe ZPP-të që planifikimin e prokurimit të mos e shohin si përgjegjësi të ndarë, por si bashkëpunim të domosdoshëm dhe atë jo vetëm gjatë fazës së planifikimit por edhe gjatë fazës së zbatimit të planit të prokurimit.

### 3. Metodologjia

INPO me qëllim që të hartoj një raport përmbajtësor dhe në përputhje me objektivat e projektit ka përdorur metodologji të kombinuar të hulumtimit. Objekt i hulumtimit është planifikimi i prokurimit të komunave për vitin fiskal 2022. Hulumtimi është i shtrirë në njëzet (20) komuna, përkatësisht në komunat: Deçan, Dragash, Ferizaj, Glogoc, Gjakovë, Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri.

Fillimisht janë shkarkuar nga platforma e-prokurimi planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2022 për secilën komunë, ku është analizuar nëse këto plane i përmbushin kriteret formale ligjore, respektivisht a janë këto plane të plotësuara konformë kërkesave LPP-së dhe Formularit B01 të aprovuar nga KRPP.<sup>1</sup>

Hulumtimi ka vazhduar me përzgjedhjen e pesë (5) aktiviteteve të para për furnizim, shërbime dhe punë që kanë iniciuar AK-të gjatë vitit 2022, këto aktivitete të iniciuara fillimisht janë analizuar se a janë në plan të prokurimit, respektivisht a janë të planifikuara. Të gjitha aktiviteteve të përfshira në monitorim, pavarësisht lëndës së prokurimit (furnizim, shërbim ose punë) u është krahasuar vlera e parashikuar e kontratës në planin e prokurimit dhe në njoftimin për kontratë. Tutje, dosjeve të tenderëve të aktiviteteve të prokurimit për furnizime u është analizuar përputhshmëria e artikujve, sasive dhe njësive me planin e prokurimit, me qëllim të vlerësimit të rregullsisë në planifikim dhe zbatim të planifikimit.

Në fund, pjesë e analizës është edhe dukuria e lidhjes së kontratave për punë shtesë, e cila në shumicën e rasteve vije si pasojë e planifikimit të dobët të prokurimit. Kësisoj INPO ka mbledhë dhe analizuar të dhëna për numrin dhe vlerën e kontratave për punë shtesë gjatë vitit 2021 në njëzet komuna.

Pas grumbullimit dhe analizimit të gjetjeve të monitorimit të aktiviteteve të prokurimit të monitoruara, INPO ka zhvilluar një anketë me ZPP-të dhe një anketë me njësitë kërkuese në njëzet (20) komuna. Anketa me ZPP-të ka përmbajtur gjithsej dhjetë (10) pyetje, prej tyre shtatë (7) pyetje të mbyllura dhe tri (3) të hapura. Anketa me njësitë kërkuese ka përmbajtur gjithsej njëmbëdhjetë (11) pyetje, prej tyre nëntë (9) pyetje të mbyllura dhe dy (2) të hapura.

Sa i përket anketës me njësitë kërkuese, INPO ka përzgjedhë njësinë kërkuese e cila gjatë vitit 2022 ka inicuar aktivitete për furnizim të cilat fare nuk ka qenë të planifikuara. Pra është intervistuar njësinë kërkuese e cila pas hulumtimit ka rezultuar se ka iniciuar aktivitete për furnizim të cilat fare nuk kanë qenë të planifikuara. Këtu bënë përjashtim Komuna e Podujevës dhe Vitisë të cilat pesë (5) aktiviteteve të para për furnizim i kanë të identifikueshme në plan të prokurimit, tek këto komuna është përzgjedhë njësinë kërkuese e cila tek aktivitetet për furnizim detajet siç

---

<sup>1</sup> Shih platformën elektronike të prokurimit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx>, gjithashtu shih Formularin B01, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>.

janë artikujt, sasitë, njësitë dhe vlerën e parashikuar nuk i kanë të njëjta si në plan të prokurimit, ashtu edhe gjatë inicimit.

Nga njëzet (20) njësi kërkuese, anketës nuk i janë përgjigj vetëm: Drejtoria e Arsimit - Komuna e Ferizajt, Drejtoria e Shëndetësisë - Komuna e Pejës, Drejtoria e Administratës - Komuna e Leposaviqit dhe Drejtoria e Arsimit - Komuna e Mitrovicës së Veriut. Gjithashtu, anketës nuk i është përgjigj ZPP i Komunës së Dragashit dhe ZPP i Komunës së Gjakovës. Raporti përfshin të dhënat deri më 1 gusht 2022.

Në fund, drafti i këtij raporti është dërguar tek të gjitha komunat e monitoruara për komente eventuale. Komentet e dhëna nga komunat janë pjesë e këtij raporti.

#### **4. Baza ligjore për planifikim të prokurimit**

Planifikimi i prokurimit është hapi i parë procedural në kuadër të prokurimit publik dhe i njëjti nënkupton një plan strategjik, një vjeçar, i bazuar në nevoja reale të qytetarëve dhe në kapacitetin buxhetor të AK-së, plan ky i cili planifikon të gjitha aktivitetet për furnizime, shërbime dhe punë të cilat AK planifikon t'i inicoj gjatë vitit përkatës. Në fakt, planifikimi i prokurimit është një proces shumë i rëndësishëm për secilin AK, përveç rëndësisë është edhe një obligim ligjor, respektivisht ky proces shumë i rëndësishëm është i rregulluar me akte ligjore dhe nënligjore.

Planifikimi i prokurimit përgatitet për periudhën dymbëdhjetë mujore, respektivisht për vitin e ardhshëm fiskal në një dokument final i cili titullohet "Plan i Prokurimit". Si një dokument i rëndësishëm, plani i prokurimit shtjellon në detaje të arsyeshme se çfarë ka nevojë, përkatësisht çka planifikon të prokuroj AK gjatë periudhës së ardhshme dymbëdhjetë mujore.

Ligji për Prokurimin Publik, fillimisht parasheh një planifikim fillestar të prokurimit publik, duke kërkuar kështu që *"Jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzoj me shkrim te Zyrari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë"*.<sup>2</sup> Pra, bëhet fjalë për një planifikim paraprak i cili mund të ndryshohet dhe plotësohet para se të marrë formën përfundimtare.

Tutje, secili AK *"Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t'i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal"*.<sup>3</sup> Nga kjo dispozitë kuptohet që planifikimi i prokurimit duhet të hartohet në

<sup>2</sup> Neni 8, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, me plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-068, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

<sup>3</sup> Po aty, neni 8, paragrafi 2.



detaje të arsyeshme, respektivisht duhet të përmbaj detajet e nevojshme lidhur me planifikimin e aktivitetit të caktuar.

Përveç ligjit, edhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik (tutje RrUOPP) përmend planifikimin e prokurimit si hapin e parë të prokurimit publik, duke i dhënë një rëndësi shumë të madhe. Në këtë drejtim RrUOPP definon se planifikimi i prokurimit është hapi i parë në procesin e prokurimit duke dhënë udhëzime lidhur me dobitë e një planifikimi të mirë dhe pasojat fatale për AK-të kur bëjnë një planifikim të dobët ose në kundërshtim me nevojat e AK-së.<sup>4</sup> Pra, përveç obligimit ligjor, planifikimi i prokurimit është i domosdoshëm në mënyrë që AK të mos përballet me situata të paparashikueshme dhe të dëmshme gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit.

Përfundimisht, planifikimi i prokurimit buron nga Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe RrUOPP, nga ku dhe e merr epitetin e dokumentit të obligueshëm ligjor për të gjitha AK-të.

## 5. Planifikimi i prokurimit për vitin 2022

Duke qenë se planifikimi i prokurimit është një dokument i obligueshëm ligjor për të gjitha AK-të, KRPP në kuadër të legjislacionit sekondar ka nxjerrë edhe një model apo formular se si duhet të jetë përmbajtja e planit përfundimtar të prokurimit.<sup>5</sup>

Ky Formular ka kërkesa dhe detaje të ndryshme varësisht natyrës dhe lëndës së prokurimit. Në rast të planifikimit të aktiviteteve për furnizime, Formulari B01 kërkon që të jepen këto informata: Titulli i aktivitetit, artikulli, njësia matëse, sasia e përafërt vjetore, çmimi për njësi, vlera e parashikuar e kontratës dhe data e planifikuar e fillimit të procedurave të prokurimit. Në rast të planifikimit të aktivitetit për shërbime dhe punë, nevojiten këto të dhëna: Titulli i aktivitetit, vlera e parashikuar e kontratës dhe data e planifikuar e fillimit të prokurimit.<sup>6</sup>

INPO ka analizuar se a i përmbajnë këto kërkesa dhe detaje formale aktivitetet e planifikuara nga njëzet (20) komunat e Republikës së Kosovës. Të dhënat i gjeni në tabelën në vijim.

Respektimi i Formularit B01 – Planifikimi i Prokurimit <sup>7</sup>										
Nr.	Komuna	Furnizime			Shërbime			Punë		
		Po	Jo	Pjesërisht	Po	Jo	Pjesërisht	Po	Jo	Pjesërisht
1	Deçan			√	√			√		
2	Dragash			√	√			√		
3	Ferizaj			√	√			√		
4	Glllogoc			√	√			√		
5	Gjakovë			√	√			√		
6	Gjilan			√	√			√		

<sup>4</sup> Shih gjithashtu RrUOPP, neni 5, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

<sup>5</sup> Për më shumë shih Formularin B01, Planifikimi i Prokurimit, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>.

<sup>6</sup> Po aty, Formulari B01.

<sup>7</sup> **Burimi:** Planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2022.

7	Kaçanik			√	√			√		
8	Kamenicë			√	√			√		
9	Klinë	√			√			√		
10	Leposaviq			√	√			√		
11	Mitrovicë e Veriut			√			√			√
12	Pejë			√	√			√		
13	Podujevë			√	√			√		
14	Prishtinë			√	√			√		
15	Prizren			√	√			√		
16	Rahovec			√	√			√		
17	Suharekë			√	√			√		
18	Shtime			√	√			√		
19	Viti			√	√			√		
20	Vushtrri			√	√			√		
<b>Gjithsej</b>		<b>1</b>	<b>0</b>	<b>19</b>	<b>19</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>19</b>	<b>0</b>	<b>1</b>

**Tabela 1:** Respektimi i Formularit B01 – Planifikimi i Prokurimit.

Nga të dhënat në tabelën më lartë rezulton se vetëm Komuna e Klinës i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme në aspekt formal të kërkuara nga Formulari B01. Ndërsa, komunat e tjera këto të dhëna i kanë në përputhje me kërkesat e Formularit B01 vetëm sa u përket aktiviteteve për shërbime dhe punë, ndërsa sa u përket aktiviteteve të planifikuara për furnizim, të dhënat janë të shprehura në mënyrë të pjesshme.

Respektivisht, këtyre aktiviteteve të planifikuara ju mungon përshkrimi i aritukujve që planifikohen të blihen përmes atij prokurim, njësia dhe sasia e përafërt. Gjetjet tregojnë se edhe nëse këto të dhëna në disa AK janë të shprehura në planifikim përfundimtar, ato nuk janë reale por vetëm “shabllone” që shërbejnë vetëm sa për të plotësuar formularin e planifikimit. Ndër shkaktarët kryesorë për planifikim të dobët në prokurimet për furnizim është edhe mungesa e administrimit dhe menaxhimit të pasurisë jo kapitale dhe stoqeve.

Në raportet vjetore të auditimit të pasqyrave financiare të AK-ve, vazhdimisht përsëritet si gjetje mungesa e regjistrimit dhe menaxhimit të pasurive jo kapitale dhe stoqeve nga organizatat buxhetore, respektivisht AK-të. Sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit mos regjistrimi i pasurive jo kapitale në posedim të komunës, rritë rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll, të gjitha asetet e saja dhe të ketë mangësi në raportim duke bërë nënvlerësimin e pasurive në pasqyrat vjetore financiare. Rrjedhimisht nuk mund të ketë as planifikim të mirëfilltë, efikas dhe eficient për nevojat e AK-së.

## 6. Respektimi i planit përfundimtar të prokurimit

Përkundër që pjesa formale, përkatësisht vendosja e detajeve për secilin aktivitet të planifikuar të prokurimit është shumë e rëndësishme, edhe më e rëndësishme është implementimi praktik i planit përfundimtar të prokurimit. Kujtojmë se mos planifikimi i prokurimit për AK-në ka pasoja

shkatërruese, njëjtë siç mund të ketë edhe mos zbatimi i planit të prokurimit.<sup>8</sup> Mos implementimi i planit të prokurimit, përkatësisht iniciimi i aktiviteteve të cilat fare nuk janë të planifikuara, mund të dërgojnë AK-në deri tek një dështim i plotë në kuadër të përmbushjes së objektivave institucionale dhe nevojave reale të qytetarëve të komunës përkatëse.

INPO ka monitoruar pesë (5) aktivitetet e para për furnizime, shërbime dhe punë, të cilat AK-të i kanë iniciuar në vitin 2022, duke analizuar dhe krahasuar se të njëjtat fillimisht a janë të planifikuara, dhe nëse janë të planifikuara detajet e paraqitura gjatë inicimit a përputhen me atë se çfarë është planifikuar me plan përfundimtar të prokurimit.

### 6.1. Respektimi i planit të prokurimit tek aktivitetet për furnizime

Ashtu siç u theksua më lartë, aktivitetet për furnizim bëjnë pjesë në aktivitetet për të cilat në Formularin B01 kërkohen detaje më të shumta, nëse krahasohet me aktivitetet e planifikuara për shërbime dhe punë. Secili aktivitet i planifikuar për furnizime duhet të ketë informata mbi titullin e aktivitetit, artikullin, njësinë matëse, sasinë e përafërt vjetore, çmimin për njësi, vlerën e parashikuar të kontratës dhe datën e planifikuar të fillimit të procedurave të prokurimit. INPO ka monitoruar atë se aktivitetet e iniciuara a janë në përputhje me atë çfarë është planifikuar me planin përfundimtar të prokurimit.

Për këtë qëllim janë hulumtuar pesë (5) aktivitetet e para për furnizim të iniciuara nga secila komunë gjatë vitit 2022, respektivisht secili nga pesë (5) aktivitetet është analizuar fillimisht a mund të identifikohet në planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2022 dhe nëse po, atëherë detajet a janë të njëjta si në planifikim të prokurimit.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur këto të dhëna për njëzet (20) komuna.

Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për furnizim me planin përfundimtar të prokurimit <sup>9</sup>									
Nr.	Komuna	Planifikimi <sup>10</sup>					Përputhja me detajet e paraqitura në plan të prokurimit <sup>11</sup>		
		1	2	3	4	5	Po	Jo	Pjesërisht
1	Deçan	√	x	√	√	√	0	3	1
2	Dragash	√	x	√	x	x	0	2	0
3	Ferizaj	√	x	√	√	√	0	3	1
4	Glllogoc	√	√	x	√	√	0	2	2
5	Gjakovë	√	√	√	x	x	0	2	1
6	Gjilan	√	√	√	x	x	0	0	3
7	Kaçanik	x	√	x	x	x	0	1	0
8	Kamenicë	x	√	√	x	√	0	2	1
9	Klinë	√	√	x	x	√	0	2	1

<sup>8</sup> Për më shumë shih nenin 5 të RrUOPP, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

<sup>9</sup> **Burimi:** Planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2022.

<sup>10</sup> **Sqarim:** Shenja (√) nënkupton se aktiviteti i inicuar ka qenë i planifikuar, ndërsa shenja (x) nënkupton se aktiviteti i inicuar nuk ka qenë i planifikuar.

<sup>11</sup> **Sqarim:** (N/A) nënkupton nuk aplikohet sepse asnjë nga aktivitetet e iniciuara nuk ka qenë i planifikuar.

10	Leposaviq	√	√	√	√	√	0	1	4				
11	Mitrovicë e Veriut	√	x	x	x	x	0	0	1				
12	Pejë	√	√	√	√	√	0	5	0				
13	Podujevë	√	√	√	√	√	0	0	5				
14	Prishtinë	x	√	√	x	√	0	3	0				
15	Prizren	x	x	x	x	x	N/A	N/A	N/A				
16	Rahovec	√	√	√	x	x	0	0	3				
17	Suharekë	√	√	√	√	x	1	1	2				
18	Shtime	√	x	√	√	√	0	3	1				
19	Viti	√	√	√	√	√	0	4	1				
20	Vushtrri	√	√	√	√	x	0	3	1				
<b>Gjithsej</b>		<table border="1"> <tr> <td><b>66</b></td> <td><b>34</b></td> </tr> <tr> <td>√</td> <td>x</td> </tr> </table>					<b>66</b>	<b>34</b>	√	x	<b>1 nga 66</b>	<b>37 nga 66</b>	<b>28 nga 66</b>
<b>66</b>	<b>34</b>												
√	x												

**Tabela 2:** Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për furnizim me planin përfundimtar të prokurimit.

Gjetjet e hulumtimit tregojnë se nga pesë (5) aktivitetet e para për furnizim në njëzet (20) komuna, një pjesë e madhe e tyre nuk kanë qenë fare të planifikuara me plan të prokurimit. Konkretisht nga njëqind (100) aktivitetet e monitoruara, tridhjetë e katër (34) prej tyre janë iniciuar pa qenë fare të planifikuara, ndërsa gjashtëdhjetë e gjashtë (66) prej tyre kanë qenë të planifikuara. Në analizimin e asaj se gjashtëdhjetë e gjashtë (66) aktivitetet të cilat janë iniciuar konformë planit të prokurimit, a përmbajnë detajet e njëjta si në plan ashtu edhe gjatë inicimit, të gjeturat tregojnë se vetëm një (1) prej tyre i përmbahet plotësisht planit të prokurimit, tridhjetë e shtatë (37) prej tyre nuk i përmbahen fare detajeve të planit të prokurimit, ndërsa njëzet e tetë (28) aktivitete i përmbahen detajeve të planifikuara në mënyrë të pjesshme.

Pra, komunat përveç që iniciojnë aktivitete të prokurimit pa qenë fare të planifikuara me planin përfundimtar të prokurimit, ato në të njëjtën kohë edhe kur iniciojnë aktivitete, të cilat për nga titulli janë të njëjta me atë çfarë kanë planifikuar, të njëjtat aktivitete nuk përmbajnë detajet, përkatësisht artikujt, sasitë, njësitë dhe vlerën e parashikuar, ashtu siç janë paraparë me plan përfundimtar të prokurimit.

## **6.2. Respektimi i planit të prokurimit tek aktivitetet për shërbime dhe për punë**

Aktivitetet për shërbime dhe aktivitetet për punë bëjnë pjesë në kuadër të aktiviteteve të cilat Formulari B01 për planifikim të prokurimit nuk kërkon edhe shumë detaje. Në fakt për këto aktivitete kërkohet vetëm titulli i aktivitetit, vlera e parashikuar e kontratës dhe data e planifikuar e fillimit të prokurimit.

INPO ka analizuar se pesë (5) aktivitetet e para për shërbime të iniciuara gjatë vitit 2022, fillimisht a janë të planifikuara dhe nëse janë të planifikuara a janë respektuar detajet tjera të parapara me plan të prokurimit. Në tabelën më poshtë janë paraqitur detajet lidhur me këto gjetje për secilën komunë.

Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për shërbime me planin përfundimtar të prokurimit <sup>12</sup>												
Nr.	Komuna	Planifikimi <sup>13</sup>					Përputhja me detajet e paraqitura në plan të prokurimit <sup>14</sup>					
		1	2	3	4	5	Po	Jo				
1	Deçan	√	√	x	√	-	3	0				
2	Dragash	x	√	√	√	x	2	1				
3	Ferizaj	√	x	√	√	√	3	1				
4	Glllogoc	√	x	x	x	x	1	0				
5	Gjakovë	√	√	√	√	√	2	3				
6	Gjilan	√	√	√	x	√	1	3				
7	Kaçanik	x	x	x	x	√	1	0				
8	Kamenicë	√	√	√	√	√	2	3				
9	Klinë	x	√	√	√	√	4	0				
10	Leposaviq	√	√	√	√	-	4	0				
11	Mitrovicë e Veriut	x	x	x	-	-	N/A	N/A				
12	Pejë	√	√	√	√	√	1	4				
13	Podujevë	√	√	√	√	√	5	0				
14	Prishtinë	x	x	x	x	x	N/A	N/A				
15	Prizren	√	√	√	x	x	3	0				
16	Rahovec	√	√	√	x	√	2	2				
17	Suharekë	√	√	√	√	√	4	1				
18	Shtime	√	√	√	√	√	4	1				
19	Viti	√	√	√	√	√	4	1				
20	Vushtrri	√	√	√	√	√	0	5				
Gjithsej		<table border="1"> <tr> <td>71</td> <td>25</td> </tr> <tr> <td>√</td> <td>x</td> </tr> </table>					71	25	√	x	46 nga 71	25 nga 71
71	25											
√	x											

**Tabela 3:** Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për shërbime me planin përfundimtar të prokurimit.

Të dhënat në tabelë dëshmojnë se nga nëntëdhjetë e gjashtë (96) aktivitetet e para për shërbime të iniciuara nga njëzet (20) komuna, vetëm shtatëdhjetë e një (71) prej tyre kanë qenë të planifikuara, ndërsa njëzet e pesë (25) prej tyre fare nuk figurojnë në planin e prokurimit për vitin 2022. Gjithashtu të dhënat tregojnë se nga shtatëdhjetë e një (71) aktivitetet të cilat kanë qenë të planifikuara, vetëm dyzet e gjashtë (46) prej tyre janë iniciuar në përputhje të plotë sipas detajeve të parapara me plan të prokurimit, ndërsa pjesa tjetër, apo njëzet e pesë (25) prej tyre janë iniciuar në kundërshtim me detajet e planifikuara me plan të prokurimit.

INPO gjithashtu ka analizuar edhe pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2022, ku pjesë e analizës është edhe ajo se a janë të planifikuara këto aktivitete me plan përfundimtar

<sup>12</sup> **Burimi:** Planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2022.

<sup>13</sup> **Sqarim:** Shenja (√) nënkupton se aktiviteti i inicuar ka qenë i planifikuar, ndërsa shenja (x) nënkupton se aktiviteti i inicuar nuk ka qenë i planifikuar. Ndërsa, shenja (-) do të thotë se komuna e caktuar deri në përfundim të monitorimit nuk ka inicuar së paku pesë (5) aktivitete për shërbime.

<sup>14</sup> **Sqarim:** (N/A) nënkupton nuk aplikohet sepse asnjë nga aktivitetet e iniciuara nuk ka qenë i planifikuar.

të prokurimit dhe nëse janë të planifikuara a janë respektuar detajet tjera të parapara me plan të prokurimit. Në tabelën më poshtë janë paraqitur detajet lidhur me këto gjetje për secilën komunë.

Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për punë me planin përfundimtar të prokurimit <sup>15</sup>												
Nr.	Komuna	Planifikimi <sup>16</sup>					Përputhja me detajet e paraqitura në plan të prokurimit					
		1	2	3	4	5	Po	Jo				
1	Deçan	√	√	x	√	√	0	4				
2	Dragash	√	√	√	√	√	5	0				
3	Ferizaj	√	√	√	√	√	5	0				
4	Glllogoc	√	x	√	√	x	2	1				
5	Gjakovë	√	√	√	√	√	3	2				
6	Gjilan	√	√	√	√	√	1	4				
7	Kaçanik	√	√	√	x	√	1	3				
8	Kamenicë	√	√	x	√	x	2	1				
9	Klinë	√	√	√	x	x	1	2				
10	Leposaviq	√	√	√	x	√	4	0				
11	Mitrovicë e Veriut	√	√	√	√	√	5	0				
12	Pejë	√	√	x	√	√	0	4				
13	Podujevë	√	√	√	√	√	3	2				
14	Prishtinë	√	√	√	√	√	4	1				
15	Prizren	x	√	x	√	x	0	2				
16	Rahovec	√	x	x	x	√	0	2				
17	Suharekë	√	√	√	√	√	1	4				
18	Shtime	x	√	√	√	√	4	0				
19	Viti	√	√	√	√	√	3	2				
20	Vushtrri	√	√	√	√	x	2	2				
<b>Gjithsej</b>		<table border="1"> <tr><td><b>82</b></td><td><b>18</b></td></tr> <tr><td>√</td><td>x</td></tr> </table>					<b>82</b>	<b>18</b>	√	x	<b>46 nga 82</b>	<b>36 nga 82</b>
<b>82</b>	<b>18</b>											
√	x											

**Tabela 4:** Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për punë me planin përfundimtar të prokurimit.

Të dhënat në tabelë tregojnë se komunat kanë iniciuar edhe aktivitete për punë të cilat fare nuk kanë qenë të planifikuara. Nga pesë (5) aktivitetet e para për punë në njëzet (20) komuna, tetëmbëdhjetë (18) aktivitete janë iniciuar pa qenë fare të planifikuara, ndërsa tetëdhjetë e dy (82) prej tyre kanë qenë të planifikuara me planin përfundimtar të prokurimit.

Në analizimin e asaj se tetëdhjetë e dy (82) aktivitetet e iniciuara sipas planit të prokurimit, a i përmbajnë detajet e njëjta si në plan ashtu edhe gjatë inicimit, të gjeturat dëshmojnë se vetëm dyzetë e gjashtë (46) aktivitete i janë përmbajtur planit të prokurimit, ndërsa pjesa tjetër,

<sup>15</sup> **Burimi:** Planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2022.

<sup>16</sup> **Sqarim:** Shenja (√) nënkupton se aktiviteti i inicuar ka qenë i planifikuar, ndërsa shenja (x) nënkupton se aktiviteti i inicuar nuk ka qenë i planifikuar.

respektivisht tridhjetë e gjashtë (36) aktivitete të iniciuara nuk përmbajnë detajet sikur në plan të prokurimit.

Në bazë të kësaj, përkundër që Formulari B01 për planifikim të prokurimit, sa u përket aktiviteteve për shërbime dhe aktiviteteve për punë, nuk kërkon shumë detaje, gjetjet dëshmojnë që as këto detaje nuk respektohen nga komunat. Në fakt përkundër që gjatë inicimit titulli i aktivitetit është i njëjtë sikur në plan, detajet tjera, posaçërisht vlera e parashikuar në shumë raste është e ndryshme dhe në kundërshtim me planin përfundimtar të prokurimit.

## **7. Dukuria e ndryshimeve të planeve përfundimtare të prokurimit në kundërshtim me dispozitat ligjore**

Plani përfundimtar i prokurimit është një dokument përfundimtar i asaj se çfarë planifikon të prokuroj brenda një viti fiskal çdo AK, dhe në bazë të ligjit *“Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t’i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal”*.<sup>17</sup>

Secila AK duhet të ketë planin përfundimtar të prokurimit, i cili përveç se siguron që AK nuk do të përballet me situata të papritura dhe urgjenca në udhëheqjen e procedurave të prokurimit, në të njëjtën kohë siguron se AK e ka një plan të prokurimit i cili i përgjigjet nevojave dhe mundësive të saj. Ndër arsyet e rëndësishme të ekzistimit të planit përfundimtar të prokurimit është dhe ajo që ky dokument duhet të dërgohet në AQP. Qëllimi i dorëzimit të planifikimit përfundimtar në AQP, është që ti ofrohet AQP-së informacion mbi prokurimet e planifikuara nga të gjitha AK-të në nivel të Republikës së Kosovës, në mënyrë që AQP të identifikoj artikujt e përdorimit të zakonshëm dhe objekte tjera dhe artikuj të cilët mund të blihen në mënyrë më efektive përmes aplikimit të procedurës së përbashkët apo të konsoliduar të prokurimit ose përmes përdorimit të kontratave qendrore kornizë.<sup>18</sup> E gjithë kjo për faktin se AQP është përgjegjëse për udhëheqjen e prokurimeve të përbashkëta.<sup>19</sup>

Vetë emërtimi plan përfundimtar i prokurimit, lë të kuptohet që ky plan është përfundimtar dhe nuk mund të rishikohet pa ndonjë rrethanë të jashtëzakonshme. Në fakt, legjislacioni në fuqi nuk potencon në mënyrë taksative se kur, apo si mund të modifikohet apo ndryshohet plani përfundimtar i prokurimit, mirëpo një gjë është e nënkuptueshme që AK-të këtë nuk duhet të bëjnë në mënyrë të pavarur dhe të pakontrolluar. Ligji gjithashtu nuk potencon se si të veprohet në rast të nevojave të domosdoshme për një ndryshim të tillë, megjithatë në praktikë si pasojë e pandemisë Covid 19, AQP ka krijuar një precedent, ku ka lejuar AK-të t’i ndryshojnë planet e

<sup>17</sup> Për më shumë shih, nenin 8, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, me plotësim ndryshim e Ligjit Nr. 05/L-068, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

<sup>18</sup> Për më shumë shih, nenin 5.8 të RrUOPP-it, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

<sup>19</sup> Shih gjithashtu, Udhëzimi Administrativ për Zbatimin e Procedurave Qendrore të Prokurimit Publik, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18812>.

prokurimit. Sado që ligji nuk i jep mandat AQP-së që të lejoj apo ndaloj ndryshimet e planeve përfundimtare të prokurimit, e njëjta nëpërmjet Njoftimit Nr. 124/20, të datës 01.07.2020, u kishte mundësuar të gjitha AK-ve ndryshimet e planeve përfundimtare të prokurimit. Arsyet e këtij ndryshimi kishin të bënin me pandeminë COVID-19, pra një rrethanë e jashtëzakonshme. Prej asaj kohe AQP nuk ka nxjerrë ndonjë njoftim apo vendim që AK-të i lejon të ndryshojnë apo modifikojnë planet përfundimtare të prokurimit.

Gjatë hulumtimit, INPO ka hasur në raste ku disa komuna kanë ndryshuar planet përfundimtare të prokurimit të ngarkuara në platformën e-prokurimi, ani pse nuk ka ekzistuar ndonjë njoftim apo vendim për një mundësi të tillë. Me të parë këtë dukuri, më 28 prill 2022, INPO ka parashtruar kërkesë për qasje në informatë në AQP, për të kuptuar se a është në dijeni AQP për këto ndryshime. Nga AQP kemi pranuar përgjigje se “Këto ndryshime nuk janë nën kontroll të kësaj Agjencie, sepse platforma elektronike e-prokurimi u lejon ndërhyrjen AK-ve sa herë të donë dhe të ndryshojnë planet përfundimtare të prokurimit”.<sup>20</sup>

Më 29 prill 2022, INPO ka kërkuar fillimisht interpretim nga KRPP se këto ndërhyrje nga AK-të pa një njoftim paraprak nga organi epror, a konsiderohen të kundërligjshme dhe së dyti ka kërkuar informatë se si është e mundur që platforma që e menaxhon KRPP-ja lejon ndërhyrje të pakufizuar nga AK-të. Më 19 maj 2022, KRPP ka potencuar se afatet kohore të planifikimit përfundimtar të prokurimit janë të qarta, duke lënë të nënkuptohet që çdo devijim i tyre është në kundërshtim me ligjin. INPO vlerëson se KRPP duhet ta sqaroj situatën se si mund të ndryshohen planet përfundimtare të prokurimit në rast të rrethanave të jashtëzakonshme siç ishte ajo me pandeminë Covid 19, sepse KRPP është institucioni përgjegjës për respektimin e dispozitave ligjore lidhur me prokurimin publik.

Ndërsa sa i përket mundësisë së pakufizuar që kanë AK-të për të ndryshuar planifikimin përfundimtar, nga Departamenti i Teknologjisë Informative në kuadër të KRPP-së është theksuar se *“Planifikimet e prokurimit mund të përgatiten, draftohen, dhe rishikohen sa herë që është e nevojshme nga ana e përdoruesve të AK-ve, ndërsa versioni final i prokurimit mund të dërgohet në AQP dhe të publikohet vetëm nga ZPP apo përdoruesit me rolin “Admin AK”. Lënia e mundësisë për AK-të që të përgatitet një plan i ri prokurimit, apo plan i rishikuar, është me qëllim që AK-të nën përgjegjësinë e tyre të kenë mundësi nëse është e domosdoshme (p.sh. rishikimi i buxhetit etj).*


INPO në anketët e zhvilluar me ZPP-të, ndër tjerash i ka pyetur të njëjtit se sa herë është ndryshuar plani i prokurimit për vitin 2022.

---

<sup>20</sup> Përgjigje telefonike nga AQP, datë 28 prill, 2022.



Nga përgjigjet e pranura nga ZPP-të lidhur me këtë pyetje, rezulton se 61% e tyre nuk kanë bërë



**Grafikoni I:** Sa herë komuna juaj e ka ndryshuar planin përfundimtar të prokurimit të ngarkuar në platformën e-prokurimit që nga momenti i miratimit të buxhetit për vitin 2022?

për publikun prezantojnë një pasqyrë jo të saktë për zbatim dhe implementim të planit të prokurimit, dhe e dyta, për faktin se AQP nuk është fare e informuar për këto ndryshime në mënyrë që të identifikoj prokurimet që futen nën kompetencën e saj. Për pasojë, shumë aktivitete anulohen për faktin se AK-të pas inicimit kuptojnë se prokurimet në fjalë janë kompetencë e AQP-së.<sup>21</sup>

asnjë ndryshim të planit përfundimtar të prokurimit për vitin 2022, ndërsa 33.3% e tyre deklarojnë se këtë e kanë bërë njëherë, kurse 5.6% deklarojnë se planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2022 e kanë ndryshuar më shumë se dy herë. Kujtojmë se këtu bëhet fjalë për ndryshime të planit përfundimtar të prokurimit të dorëzuar në AQP.

Pra, aktualisht AK-të në mënyrë krejtësisht të pa kontrolluar dhe pa një lejim paraprak nga AQP, janë duke modifikuar planet përfundimtare të prokurimit dhe për INPO-n, kjo dukuri është shumë shqetësuese dhe atë për dy arsye kryesore. E para, me modifikimet e planeve përfundimtare të prokurimit AK-të përveç rreziqeve të brendshme për prokurime të paplanifikuara dhe urgjente, në të njëjtën kohë

## 8. Njësitë kërkuese dhe planifikimi i prokurimit

Njësia kërkuese është organi i caktuar brenda AK-së i cili ka për përgjegjësi përbushjen e kërkesave të caktuara të AK-së nëpërmjet procedurave të prokurimit. Në nivel të komunave, zakonisht njësi kërkuese janë drejtoritë komunale të cilat janë të ndara varësisht nga kompetencat dhe përgjegjësitë e komunave. Kështu duke filluar nga financat, administrata, shërbimet publike, projektet kapitale, bujqësia, kultura e kështu me radhë. Pra, përveç që këto drejtori angazhohen për një qeverisje të departamenteve që u përkasin, shumica e tyre në kuadër të përbushjes së kompetencave dhe përgjegjësisive kanë nevojë edhe për procedura të prokurimit.

Njësitë kërkuese u ndahet buxheti i caktuar, të cilat pastaj brenda atij buxheti planifikojnë aktivitetet që kanë për qëllim t'i iniciojnë nëpërmjet procedurave të prokurimit gjatë vitit të

<sup>21</sup> Për më shumë shih raportin e INPO-s, “Pa ligjshmëria e tenderëve të anuluar”, i qasshëm në: <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/Raport-Pa-Ligjshm%C3%ABria-e-tender%C3%ABve-t%C3%AB-anuluar.pdf>.

caktuar fiskal. Në fakt, kjo fazë njihet si planifikim paraprak ku të gjitha njësitë kërkuese paraqesin kërkesat e tyre në drejtim të ZKA-së, më së largu deri më 31 dhjetor të çdo viti fiskal.<sup>22</sup>

Tutje, pas aprovimit të ZKA-së, planifikimet nga të gjitha njësitë kërkuese dërgohet tek ZPP, ku pastaj nga ZPP adaptohen në planin përfundimtar të prokurimit dhe ngarkohen në platformën elektronike e-prokurimi. Nga kjo mund të përfundojmë se kompetenca për përgatitjen e planit të prokurimit fillimisht është e njërive kërkuese, të cilat i përgatisin nevojat reale të cilat i kanë dhe këto nevoja pastaj dërgohen tek ZKA, ku pas aprovimit të ZKA-së planifikimi i secilës kërkesë shkon tek zyra e prokurimit për tu vendosur në formularin standard B01. RrUOPP, duke shpjeguar kompetencat e njësisë kërkuese ka theksuar se ndër tjerash njësitë kërkuese janë kompetente edhe për përgatitjen e një kërkesë të prokurimit, vlerësimin formal të nevojave (DNPDF), dhe përcjelljes së tyre tek ZKA për aprovim dhe të bashkëpunojë dhe të asistoj departamentin e prokurimit gjatë procesit të prokurimit.<sup>23</sup> Pra, përgjegjësi e njësisë kërkuese është vlerësimi i nevojave përkatësisht konkretizimi i aktiviteteve me të cilat do të përmbushen ato nevoja dhe dërgimi i kësaj liste me aktivitete për aprovim në ZKA. Ndërsa hapi i dytë është bashkëpunimi me njësinë/zyrën e prokurimit lidhur me aktivitetet e aprovuara nga ZKA.

Kësisoj, inicimi i aktiviteteve të planifikuara të prokurimit, është përgjegjësi e njësisë kërkuese, e cila kërkon që plani i saj i punës të implementohet përmes procedurave të prokurimit siç është paraparë edhe me planin e prokurimit gjatë fazës planifikuese, si për nga koha ashtu edhe për nga volumi. Respektivisht, çdo aktivitet i inicuar i cili devijon planifikimet e prokurimit, vije me kërkesë të njësisë kërkuese, apo me kërkesë të ZKA-së, përmes njësisë kërkuese.

## **9. Rezultatet e anketës me njësitë kërkuese**


INPO ka zhvilluar anketë në 20 komuna, respektivisht me nga një (1) njësi kërkuese, përkatësisht një (1) drejtori në secilën komunë të fokusit. Njësia kërkuese, sipas metodologjisë është përzgjedhur ajo njësi e cila tek pesë (5) aktivitetet e para për furnizim, ka pasur të inicuar aktivitetet të prokurimit i cili fare nuk ka qenë i planifikuar. Nga njëzet (20) njësi kërkuese në njëzet (20) komuna, anketës nuk i janë përgjigj vetëm: Drejtoria e Arsimit - Komuna e Ferizajt, Drejtoria e Shëndetësisë – Komuna e Pejës, Drejtoria e Administratës – Komuna e Leposaviqit dhe Drejtoria e Arsimit – Komuna e Mitrovicës së Veriut. Zhvillimit i anketës ka pasur për qëllim marrjen e qëndrimeve dhe opinioneve të njërive kërkuese/ drejtorive komunale në raport me (mos) përfshirjen tyre aktive në planifikimin e prokurimit. INPO fillimisht ka pyetur njësitë kërkuese të komunave se sa është numri i aktiviteteve të planifikuara nga ato njësi, përkatësisht drejtori për vitin 2022.

---

<sup>22</sup> Për më shumë, shih nenin 5.5 të RrUOPP-it, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret//shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.


<sup>23</sup> Po aty, neni 10.1, pika (a dhe d).

Nga përgjigjet e drejtorive, gjejmë se 25% e tyre për vitin 2022 kanë të planifikuara, mbi njëzet



**Grafikoni 2:** Sa aktivitete të prokurimit ka planifikuar drejtorja juaj për vitin 2022?

dhënë përgjigje të ndara në dysh. 43.8% prej tyre mendojnë se përgjegjës është vetëm njësi kërkuese, ndërsa po aq mendojnë se përgjegjës është njësi kërkuese në bashkëpunim me zyrën



**Grafikoni 3:** Kush mendoni se është përgjegjës për përgatitjen e planifikimit të prokurimit?

mendoni që drejtorja juaj për vitin 2022 ka planifikuar në planin përfundimtar të prokurimit të gjitha aktivitetet në përputhje me nevojat reale dhe buxhetin e dedikuar, vetëm 81.3% e tyre kanë vlerësuar se po, ndërsa pjesa tjetër mendojnë se ky planifikim i përgjigjet pjesërisht nevojave dhe kapaciteteve buxhetore të komunës.

Në pyetjen se pse tek aktivitetet për furnizim nuk i planifikoni në detaje duke përfshirë: sasitë e përafërta, njësitë dhe artikujt, ashtu siç kërkohen me Formularin B01, 50% e drejtorive theksojnë se komunat e tyre planin e prokurimit e hartojnë me këto detaje. Ndërkaq, për qëllime të këtij raporti, vlen të përmendet se INPO ka monitoruar procesin e planifikimit të tenderëve për


Në pyetjen se kush është përgjegjës për përgatitjen e planifikimit të prokurimit, drejtoritë, respektivisht njësitë kërkuese kanë në bashkëpunim me zyrën e prokurimit. Përveç kësaj, 6.3% e drejtorive mendojnë se përgjegjës është vetëm zyra e prokurimit, ndërsa 6.3% tjerë mendojnë se përgjegjës është drejtoria me sektorët e saj.

Nga këto përgjigje vërejmë se mungon një bashkëpunim i duhur në mes të ZPP-ve dhe njësive kërkuese gjatë kësaj faze shumë të rëndësishme, dhe kjo mungesë e bashkëpunimit vërehet nga rezultatet e anketës kur mbi 43% e njësive kërkuese potencojnë se vetëm ata janë përgjegjës për përgatitjen e planifikimit të prokurimit.

Përkundër që shumica e drejtorive janë përgjigjur që planifikimin e prokurimit e përgatisin ose vetë, ose në bashkëpunim me ZPP-të, të njëjtit në pyetjen e parashtruar se a

furnizime dhe janë gjetur shumë parregullsi, sidomos tek pjesa e planifikimit të sasive, njësisive dhe artikujve. Rezultatet e këtij monitorimi i gjeni në tabelën I të këtij raporti.

Tutje, një shqetësim i rëndësishëm dhe sfidë me të cilën ballafaqohen AK-të, sidomos njësitë kërkuese është fakti i mungesës së resurseve njerëzore të cilët mund të angazhohen për planifikim profesional të prokurimit.



Kjo dëshmohet edhe me atë se 12.5% e drejtorive janë përgjigjur se ato nuk kanë kapacitete që të planifikojnë edhe artikujt, sasitë dhe njësitë, pra, nuk e kanë mohuar përgjegjësinë por kanë theksuar se nuk kanë kapacitete për një gjë të tillë. Ndërsa, shumë shqetësues është fakti se 12.5% e drejtorive kanë theksuar se nuk është e nevojshme paraqitja e artikujve, sasive dhe njësisive tek aktivitetet e prokurimit, përgjigje të cilat bien në kundërshtim me përgjigjet e pyetjes “Pse aktivitetet për furnizim nuk i planifikoni në detaje të arsyeshme” Pra, përveç mungesës së kapaciteteve, këtu vihet në pah fakti se kemi edhe mungesë kompetence e profesionalizmi lidhur me atë se si hartohet një plan i prokurimit dhe çka duhet të përmbajë i njëjti.


**Grafikoni 4:** Pse tek aktivitetet për furnizim nuk i planifikoni në detaje të mjaftueshme dhe të sakta: sasitë, njësitë dhe artikujt?

INPO gjithashtu ka pyetur drejtoritë se pse vije deri tek situata kur AK inicon aktivitetet të cilat fare nuk janë të planifikuara dhe 62.5% e tyre potencojnë se kjo ndodh për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, 12.5% mendojnë se kjo ndodh për shkak të planifikimit jo të duhur, ndërsa 25% e tyre theksojnë se në komunën e tyre nuk ka raste të tilla.

Përveç problemeve dhe sfidave tjera, AK-të që nga fundi i vitit 2021 janë duke u përballur edhe me një situatë tjetër e cila ka të bëjë me ngritjen e çmimeve të tregut, ku për pasojë, shumë kontrata nuk kanë arritur të përmbushen.<sup>24</sup>


Meqë vitin e kaluar rritja e çmimeve ka ardhur krejt papritur, viti 2022 AK-të i ka gjetur me çmime të larta të tregut. Në këtë kuptim INPO ka pyetur të anketuarit se a mendojnë se drejtoria e tyre do të arrijë t'i prokurojë të gjitha aktivitetet sipas planifikimit.

<sup>24</sup> Për më shumë, shih artikullin i cili flet për rritjen e çmimeve në Kosovë, i qasshëm në: <https://www.evropaelire.org/a/ngritje-e-pakontrolluar-e-çmimeve-ne-kosove/31746706.html>.



**Grafikoni 5:** Për shkak të rritjes së çmimeve të tregut a mendoni që drejtorja juaj do të arrijë t'i prokurorë të gjitha aktivitetet sipas planifikimit?

poentim prej numrit një (1) si vlerësimi më i ulët, deri në numrin dhjetë (10) si vlerësimi më i lartë. 31.3% e drejtorive planin e prokurimit të AK-së që i takojnë e vlerësojnë me pikë



**Grafikoni 6:** Prej 1 deri 10, sa e vlerësoni planifikimin e drejtorisë tuaj?

pastaj planifikimi i projekteve me kohë, rritja e resurseve njerëzore, vlerësim i duhur i tregut, e kështu me radhë.<sup>25</sup>

Përgjithësisht, pa përjashtuar mendimet e njësive kërkuese, për një planifikim profesional dhe të zbatueshëm domosdoshmërisht duhet të konsiderohen disa faktorë. Fillimisht njësitet kërkuese duhet të kuptojnë qartë kompetencën për të hartuar planin e prokurimit dhe duhet të jenë profesional në këtë drejtim, pastaj i një rëndësie të madhe është bashkëpunimi me ZPP-të,

Nga përgjigjet e dhëna, vetëm 31.3% e njësive kërkuese, apo drejtorive të komunave mendojnë se AK-ja do të arrijë të implementoj planin e prokurimit duke marrë parasysh ngritjen e çmimeve të tregut. 62.5% e tyre thonë që do të implementohet por me vështirësi, ndërsa 6.3% mendojnë se nuk ka asnjë mundësi që plani përfundimtar i prokurimit të implementohet në tërësi për shkak të ngritjes së çmimeve.

INPO përmes anketës ka kërkuar që drejtoritë apo njësitet kërkuese që të vlerësojnë kënaqshmërinë e tyre me planin e prokurimit të AK-së të cilës u takojnë, duke përcaktuar një maksimum, përkatësisht me dhjetë (10), pastaj 31.3% e tyre e vlerësojnë me nëntë (9) pikë, 18.8% e vlerësojnë me tetë (8) pikë, 12.5% me shtatë (7) pikë dhe 6.3% me gjashtë (6) pikë, ndërsa për poentimin prej pesë (5) deri një (1) pikë nuk ka pasur vlerësim. Në përgjithësi vërehet një vlerësim i kënaqshëm i planifikimit përfundimtar të prokurimit, përkundër që vetëm 31% e tyre mendojnë që do të mund të zbatohet gjithçka që është planifikuar me plan të prokurimit.

Në fund INPO ka pyetur drejtoritë se sipas tyre çka do të mund të ndikonte, që AK-të të kenë një planifikim cilësor dhe të bazuar në nevojat reale të tyre. Përgjigjet fillojnë nga ajo se duhet të ekzistojnë disa çmime referente,

<sup>25</sup> Lidhur me mungesën e listës së çmimeve referente, shih raportin e INPO-s, "Planifikimi i prokurimit në mes të formalitetit dhe profesionalizmit", i qasshëm në: <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/Planifikimi-i-prokurimit-n%C3%AB-mes-t%C3%AB-formalitetit-dhe-profesionalizmit.pdf>.

vlërësimi i tregut, planifikimi konformë mundësive buxhetore e kështu me radhë. Çdo dështim i këtyre faktorëve, planifikimin e prokurimit e bënë jo profesional, të dobët dhe vështirë të zbatueshëm në praktikë.

## **10. Zyrtarët Përgjegjës të Prokurimit dhe planifikimi i prokurimit**

ZPP është personi i cili udhëheq me zyrën e prokurimit brenda AK-së. Rrjedhimisht zyra e prokurimit mund të përbëhet nga disa zyrtarë të prokurimit, ndërsa mund të jetë vetëm një zyrtarë përgjegjës i prokurimit. Sipas Ligjit, ZKA *“Përcakton një person të shërbej si Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit për autoritetin kontraktues. Nëse punëtorët tjerë të autoritetit kontraktues janë nëpunës civil, Zyrtari i Prokurimit gjithashtu është nëpunës civil”*.<sup>26</sup>

ZPP është personi kryesor përgjegjës për udhëheqjen e procedurave të prokurimit dhe është person kontaktues edhe për institucionet tjera siç janë KRPP, OShP, AQP etj. Madje, për çdo ndryshim të ZPP-ve, AK-të duhet të njoftojnë KRPP-në.<sup>27</sup>

Vetë fakti që ZPP është personi përgjegjës për udhëheqjen e procedurave të prokurimit, është e nënkuptueshme që përgjegjësitë e tij shtrihen edhe tek planifikimi i prokurimit. Kjo mbështetet në kualifikimet profesionale që ka ZPP, për shembull kur një aktivitet i planifikuar nga njësia kërkuese nuk i ka të gjitha detajet që kërkohen, atëherë ZPP duhet të kërkojë që ato të plotësohen në mënyrë që pastaj të vendosen në plan përfundimtar të prokurimit.

Dispozitat ligjore kërkojnë një angazhim konkret dhe aktiv të ZPP-së gjatë fazës së planifikimit, ku taksativisht potencohet se *“Për të kryer një planifikim të mirë të prokurimit zyrtarit të prokurimit do ti nevojitet bashkëpunimi i ngushtë me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera. Zyrtari i prokurimit do të takohet me personat përgjegjës për buxhet dhe departamentet që bëjnë kërkesat (përdoruesit) dhe të diskutojë kërkesat e tyre për prokurim dhe buxhetin në disponueshmëri për vitin e ardhshëm dhe do të vendosë cilët artikuj të përfshihen në planifikimin paraprak dhe final të prokurimit”*.<sup>28</sup>

Pra, sado që planifikimi i prokurimit burimin e ka tek njësitë kërkuese, ZPP është përgjegjësi kryesor që planifikimi i prokurimit të jetë në përputhje me kërkesat ligjore, përkatësisht planifikimi të jetë në përputhje me kapacitetet buxhetore, të jetë i detajuar me të gjitha informatat dhe detajet e kërkuara me ligj, përkatësisht me Formularin B01. Të gjitha këto sigurisht që nuk mund të arrihen pa një komunikim të vazhdueshëm në mes të ZPP-ve dhe njësisive kërkuese.

## **11. Rezultatet e anketës me Zyrtarët Përgjegjës të Prokurimit**

Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm të ZPP-ve në kuadër të planifikimit të prokurimit, INPO ka zhvilluar anketë me ZPP-të e njëzet (20) komunave të monitoruara. Anketa ka për qëllim të

<sup>26</sup> Neni 23, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i qasshëm në: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.


<sup>27</sup> Pa aty, neni 24, paragrafi 4.

<sup>28</sup> Shih neni 5.13, të RrUOPP-it, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

identifikoj sfidat e ZPP-ve, lidhur me hartimin e planit të prokurimit, bashkëpunimi me njësitë kërkuese, evidentimi i shkaktarëve që dërgojnë në inicime të aktiviteteve të prokurimit të pa planifikuara, sfidat me ngritjen e çmimeve të tregut si dhe problematika e punëve shtesë. Anketës nuk i është përgjigjur vetëm ZPP i Komunës së Dragashit dhe ZPP i Komunës së Gjakovës.

INPO nëpërmjet anketës, fillimisht ka pyetur ZPP-të se plani përfundimtar i prokurimit a i përmbush nevojat reale të AK-së që i përkasin.

Siç mund të shihet në grafikun, pjesa më e madhe e ZPP-ve, apo 55.6% deklarojnë se plani përfundimtar i prokurimit i hartuar nga komuna



e tyre i përmbush pjesërisht nevojat e komunës, ndërsa 44.4% e tyre deklarojnë se plani përfundimtar i prokurimit i përmbush plotësisht nevojat e komunës të cilës i përkasin.

Për ZPP-të të cilët kanë deklaruar se plani përfundimtar i prokurimit nuk i përgjigjet nevojave reale të komunës, INPO ka parashtruar pyetje se cilët janë shkaktarët për një gjë të tillë. Lidhur me këtë pyetje, 40% e ZPP-ve mendojnë se arsyet qëndrojnë aty se AK përballlet me situata të paparashikueshme, 30% mendojnë se mungojnë metodat dhe strategjitë adekuate për planifikim të duhur, ndërsa pjesa tjetër vlerësojnë se kjo ndodh për shkak të shkaktarëve tjerë që nuk janë nën kontrollin e AK-së.


**Grafikoni 7:** A i përgjigjet nevojave reale të komunës tuaj plani përfundimtar i prokurimit për vitin 2022?

Meqë gjatë hulumtimit janë evidentuar raste të shumta kur AK-të iniciojnë aktivitete të cilat fare nuk kanë qenë të planifikuara, INPO ka pyetur ZPP-të se pse ndodh një gjë e tillë. Dhjetë (10) nga tetëmbëdhjetë (18) ZPP-të që i janë përgjigjur anketës, kanë deklaruar se kjo ndodh për faktin e marrëveshjeve të mirëkuptimit me ministrinë e linjës, apo projekte të cilat janë të financuara nga donatorë të ndryshëm. Ndërsa pjesa tjetër e ZPP-ve, potencojnë se kjo ndodh për faktin se ZPP nuk ftohet gjatë fazës së hartimit të buxhetit, për shkak të situatave urgjente dhe për shkak të mbetjeve buxhetore nga projektet tjera.

Ashtu siç janë pyetur edhe njësitë kërkuese, INPO ka parashtruar pyetje edhe për ZPP-të lidhur me masat eventuale që ata kanë marrë pas ngritjes së çmimeve të tregut.



Konkretisht ZPP-të janë pyetur se duke marrë parasysh ngritjen e çmimeve të tregut, a keni marrë ndonjë masë në kuadër të ndryshimit të planit përfundimtar të prokurimit për vitin 2022.



**Grafikoni 8:** Duke marrë parasysh ngritjen e çmimeve të tregut, a keni marrë ndonjë masë në kuadër të ndryshimit të planit përfundimtar të prokurimit për vitin 2022?

Sipas rezultatetve, 50% e ZPP-ve të cilat i janë përgjigj anketës nuk kanë marrë asnjë masë në kuadër të rishikimit të planit përfundimtar të prokurimit për shkak të ngritjes së çmimeve, 17% theksojnë se e kanë bërë një gjë të tillë, 22% vlerësojnë se një gjë e tillë nuk është e lejuar me ligj, ndërsa 11% theksojnë që do e bëjnë në të ardhmen.

Duhet theksuar që këto përgjigje vijnë përkundër asaj që plani përfundimtar i prokurimit i vitit 2022 është ndryshuar së paku një herë në afër 40% të komunave që i janë përgjigj anketës, andaj rezulton se këto ndryshime nuk kanë qenë të lidhura me rritjes së çmimeve, por planet janë ndryshuar për arsye tjera.<sup>29</sup> ZPP-të të cilët kanë deklaruar se kanë marrë masa lidhur me ngritjen e çmimeve, janë

pyetur se cilat kanë qenë ato masa, ndërsa përgjigjet janë se: “Kemi shkurtuar projektet, kemi ngritur vlerën e parashikuar të aktiviteteve dhe kemi zvogëluar sasi të”.

## 12. Planifikimi i prokurimit dhe punët shtesë

Punët shtesë përmes aneks kontratave janë një mundësi ligjore të cilat AK-së i mundësojnë që me OE-në i cili është duke implementuar një kontratë, të negocioj punën, furnizimin apo shërbimin e caktuar i cili ndodh në mënyrë krejtësisht të paparashikuar dhe si pasojë e impelmentimit të kontratës bazë. Ligji përcakton në mënyrë të qartë se këto punë shtesë nuk mund të tejkalojnë vlerën 10% të kontratës bazë, se mund të ndodhin vetëm njëherë, dhe procedura e dhënies së kontratës për punë shtesë është procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë.<sup>30</sup>

Pra, punët shtesë lejohen kur gjatë implementimit të kontratës bazë paraqiten rrethana të paparashikueshme, të cilat kërkojnë, apo shkaktojnë shpenzime dhe punë shtesë për OE-në e kontraktuar për kontratën bazë dhe për pasojë nevojitet një aneks kontratë e cila nuk do të kalojë vlerën 10% të kontratës. Realisht kontrata për punë shtesë negociohet direkt me OE-në i cili është duke e implementuar kontratën bazë dhe për këto lloj kontratash nuk ka fare konkurrencë.

Kohëve të fundit INPO ka evidentuar se AK-të e kanë shtuar në mënyrë të dukshme numrin e kontratave për punë shtesë, duke rritur shqetësimin se kjo mundësi ligjore është duke u

<sup>29</sup> Për më shumë shih grafikonin numër 1.

<sup>30</sup> Për më shumë shih nenin 35, paragrafi 2, nënparagrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, me plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-068, i qasëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.



keqpërdorur. Shqetësimet burojnë nga ajo se për shumë raste kjo formë e kontratës aplikohet jo vetëm për punët shtesë që dalin si pasojë e implementimit të kontratës, por për punët shtesë si rezultat i planifikimit të dobët nga ana e AK-ve. Pastaj shqetësimi tjetër vije nga ajo se kjo mundësi ligjore shfrytëzohet edhe në rastet kur fare nuk shkaktohen punë shtesë, mirëpo AK e shfrytëzon si mundësi ligjore për të negociuar aneks kontratën direkt me OE-në i cili është në vazhdim e sipër të implementimit të kontratës bazë, si dhe ajo se në shumicën e rasteve kur kemi kontrata për punës shtesë, AK-të e shfrytëzojnë saktësisht 10%, apo një vlerë shumë të afërt me 10% të kontratës bazë, gjë e cila shton edhe më tej dyshimet për keqpërdorim të kësaj mundësie ligjore.

INPO ka analizuar kontratat për punë shtesë (ankes kontratat) të nënshkruara nga AK-të gjatë vitit 2021, kontrata bazë e të cilave ka qenë kontratë e llojit punë. Pra, janë analizuar kontratat për punë shtesë lidhur me aktivitetet për punë të nënshkruara nga AK-të gjatë vitit 2021. Pastaj numri i kontratave për punë shtesë është krahasuar me numrin e kontratave për punë që kanë planifikuar AK-të për vitin 2021 me plan të prokurimit. E gjithë kjo për të krahasuar në aspekt numerik atë se për sa nga aktivitetet e planifikuara për punë, gjatë implementimit të kontratës nënshkruhet edhe kontratë për punë shtesë.


Këto të dhëna janë të paraqitura në tabelën më poshtë.

Kontratat për punë të cilat gjatë vitit 2021 kanë pasur punë shtesë <sup>31</sup>				
Komuna	Numri i kontratave për punë shtesë	Numri i kontratave për punë në plan të prokurimit 2021	Përqindja	Vlera e kontratave për punë shtesë gjatë vitit 2021
Deçan	6	16	37.50%	634,971.07€
Dragash	7	62	11.29%	22,408.83€
Ferizaj	18	46	39.13%	1,155,541.58€
Glllogoc	4	65	6.15%	80,061.45€
Gjakovë	27	49	55.10%	307,054.50€
Gjilan	8	16	50%	329,881.89€
Kaçanik	10	55	18.18%	84,786.84€
Kamenicë	8	10	80%	39,919.46€
Klinë	12	39	30.76%	64,580.11€
Leposaviq	1	10	10%	11,880.00€
Mitrovicë e Veriut	2	4	50%	36,513.40€
Pejë	12	88	13.63%	147,287.44€
Podujevë	12	60	20%	117,858.97€
Prishtinë	7	91	7.69%	50,857.60€
Prizren	11	113	9.73%	157,208.82€
Rahovec	15	32	46.87%	515,440.05€
Suharekë	16	76	20.25%	458,220.13€
Shtime	11	35	31.42%	66,112.64€
Viti	3	19	15.78%	83,541.79€
Vushtrri	1	28	3.57%	177,563.42€
<b>Gjithsej</b>	<b>191</b>	<b>914</b>	<b>20.89%</b>	<b>4,541,689.99€</b>

**Tabela 5:** Kontratat për punë të cilat gjatë vitit 2021 kanë pasur punë shtesë.

<sup>31</sup> Burimi: Raporti i kontratave publike të nënshkruara gjatë vitit 2021 dhe platforma elektronike e-prokurimi, e qasme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx>.


Nga të dhënat në tabelën më lartë dëshmohej në njëzet (20) komuna, numri i aktiviteteve të planifikuara për punë gjatë vitit 2021 është gjithsej nëntëqind e katërbëdhjetë (914), ndërsa numri i kontratave për punë shtesë gjatë po të njëjtit vit është njëqind e nëntëdhjetë e një (191). Bazuar në këto të dhëna del se mesatarisht 20.89% e kontratave bazë, kanë pasur të nënshkruar edhe kontratë për punë shtesë, me një vlerë prej 4,541,689.99 euro. Gjithashtu, referuar të dhënave në tabelë, dëshmohej se në mesin e komunave ka raste kur numri i kontratave për punë shtesë tejkalon më shumë se 50% numrin e kontratave të planifikuara për punë gjatë vitit 2021. Këtu bëjnë pjesë Komuna e Kamenicës me 80%, Komuna e Gjakovës me 55.10%, Komuna e Gjilanit dhe Mitrovicës së Veriut me nga 50%.



**Grafikoni 9:** A mendoni që mundësia për punë shtesë është duke u keqpërdorur nga autoritetet kontraktuese, përkatësisht punët shtesë nuk kanë të bëjnë saktësisht me atë çfarë në fakt nënkupton ligji?

INPO, përmes anketës ka pyetur ZPP-të se a mendojnë që mundësia për punë shtesë është duke u keqpërdorur nga AK-të, përkatësisht punët shtesë nuk kanë të bëjnë saktësisht me atë çfarë në fakt nënkupton ligji dhe rezultatet janë si në vijim: 66.6% e tyre mendojnë se mundësia për punë shtesë nuk është duke u keqpërdorur nga AK-të, 11.1% deklarojnë se nganjëherë keqpërdoret kjo mundësi ligjore, 5.6% mendojnë se kemi të bëjmë me keqpërdorim lidhur me punët shtesë, 11.1% potencojnë se kjo nuk është përgjegjësi e vetëm ZPP-së por edhe ZKA-së, ndërsa 5.6% të ZPP-ve nuk kanë mendim lidhur me këtë pyetje. Pra, një pjesë e ZPP-ve mendojnë se AK-të e keqpërdorin mundësinë ligjore për punë shtesë dhe kjo është me të vërtetë shqetësuese.

Meqë disa nga punët shtesë lidhen ngushtë me planifikimin jo adekuat apo të mirëfilltë e prokurimit, INPO gjithashtu ka pyetur ZPP-të se a ka raste kur në komunën tuaj autorizohen punë shtesë për shkak të mos planifikimit të duhur.



**Grafikoni 10:** A ka raste kur në komunën tuaj autorizohen punë shtesë për shkak të mos planifikimit të duhur?

Nga përgjigjet e ZPP-ve, rezulton se 61% e tyre mendojnë se asnjëherë punët shtesë nuk kanë të bëjnë me planifikim jo të duhur të prokurimit, 27.9% e ZPP-ve theksojnë se kjo ndodh nganjëherë, ndërsa 11.1% e ZPP-ve kanë përgjigje tjera të cilat as nuk pohojnë, e as nuk mohojnë se në AK-në e tyre autorizohen punë shtesë për shkak të planifikimit jo të duhur.

Në bazë të kësaj që u tha më lartë, se punët shtesë janë të lidhura ngushtë edhe me planifikimin jo të duhur të AK-ve, dhe në disa raste kontratat për punë shtesë autorizohen pikërisht për të mbuluar keq planifikimin nga AK. Kjo përveç që shpërfaqë një planifikim jo cilësor, në të njëjtën kohë mund të ndikoj që AK të paguaj më shtrenjtë për furnizimin, shërbimin apo punën e caktuar. Kjo për faktin se punët shtesë iniciohet nëpërmjet procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë, dhe në disa raste nuk janë thjeshtë punë shtesë por janë punë të paparashikuara dhe të cilat as që janë paraparë në kontratën bazë.

AK-të, ZPP-të dhe njësitë kërkuese duhet të kenë të qartë se aplikimi i punës shtesë është i ligjshëm vetëm në rastet e parapara me ligj, përkatësisht vetëm atëherë kur si pasojë e ekzekutimit të kontratës bazë dalin furnizime, shërbime apo punë shtesë të paparashikuara dhe të njëjtat nuk kanë mundur të planifikohen dhe të heqin dorë nga praktikatat e tilla të përligjjes së planifikimeve të dobëta dhe keq menaxhimit të parasë publike.

### 13. Gjetjet kryesore

- 19 nga 20 komunat e monitoruara nuk i paraqesin të gjitha detajet formale të kërkuara në planin përfundimtar të prokurimit.
- Nga njëqind (100) aktivitetet e monitoruara për furnizim, vetëm gjashtëdhjetë e gjashtë (66) prej tyre figurojnë në planin e prokurimit, pjesa tjetër janë iniciuar pa qenë fare të planifikuara.
- Në njëzet (20) komuna, vetëm një (1) aktivitet për furnizim i ka detajet e njëjta si në plan të prokurimit, ashtu edhe gjatë inicimit.
- Nga nëntëdhjetë e gjashtë (96) aktivitetet e monitoruara për shërbime, vetëm shtatëdhjetë e një prej tyre figurojnë në planin përfundimtar të prokurimit, pjesa tjetër janë iniciuar pa qenë fare të planifikuara.
- Nga njëqind (100) aktivitetet e monitoruara për punë, vetëm tetëdhjetë e dy (82) aktivitete janë iniciuar sipas planit të prokurimit, pjesa tjetër nuk figurojnë fare në plan.
- Afër 40% e komunave kanë ndryshuar planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2022, ndërsa nuk ekziston ndonjë dispozitë konkrete ligjore e cila e thekson në mënyrë të qartë se kur lejohet të bëhet një ndryshim i tillë.
- Njësitë kërkuese nuk e kanë të qartë se kujt i takon përgjegjësia për planifikimin e prokurimit, përderisa 43.8% e tyre mendojnë se kjo përgjegjësi është e përbashkët në mes të ZPP-ve dhe njësive kërkuese, po aq mendojnë se kjo përgjegjësi i takon vetëm njësive kërkuese.
- 12.5% e njësive kërkuese potencojnë se nuk kanë kapacitete për të vendosur artikujt, sasitë dhe njësitë në planin përfundimtar të prokurimit, ndërsa 12.5% tjerë mendojnë se nuk është e nevojshme paraqitja e artikujve, sasive dhe njësive tek aktivitetet e prokurimit.
- Si pasojë e rritjes së çmimeve të tregut, vetëm 31.3% e njësive kërkuese në kuadër të komunave të monitoruara mendojnë se AK do të implementoj planin e prokurimit.
- 56% e ZPP-ve të komunave vlerësojnë se plani përfundimtar i prokurimit i përmbush pjesërisht nevojat e komunës të cilës i përkasin.
- Vetëm 17% e ZPP-ve potencojnë se kanë marrë masa në kuadër të planifikimit të prokurimit me qëllimin që planifikimet të jenë konform rritjes së çmimeve të tregut.
- Gjatë vitit 2021, njëzet (20) komunat e monitoruar kanë nënshkruar njëqind e nëntëdhjetë e një (191) kontrata për punë shtesë lidhur me aktivitetet për punë, ndërsa vlera e punëve shtesë është 4,541,689.99 euro.

- Tek Komuna e Kamenicës, Gjakovës, Gjilanit, Mitrovicës së Veriut, numri i kontratave për punë shtesë tejkalon më shumë se 50% numrin e kontratave të planifikuara për punë gjatë vitit 2021.
- 5.6% e ZPP-ve vlerësojnë se AK-të e keqpërdorin mundësinë për punë shtesë, ndërsa 11.1% të ZPP-ve theksojnë se kjo mundësi ligjore keqpërdoret ndonjëherë.

## 14. Rekomandimet

- Komunat të kujdesen që plani përfundimtar prokurimit të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe Formularin B01, respektivisht t'i përmbaj të gjitha të dhënat e nevojshme lidhur me aktivitetet për furnizim, shërbime dhe punë.
- Përjashtuar Komunën e Pejës, Podujevës dhe Vitisë, komunat tjera të sigurohen se nuk iniciojnë aktivitete për furnizim të cilat fare nuk janë të planifikuara.
- Komuna e Deçanit, Dragashit, Ferizajt, Glllogocit, Gjilanit, Kaçanikut, Klinës, Mitrovicës së Veriut, Prishtinës, Prizrenit dhe Rahovecit të sigurohen se nuk iniciojnë aktivitete për Shërbime të cilat fare nuk janë të planifikuara.
- Komuna e Deçanit, Glllogocit, Kaçanikut, Kamenicës, Klinës, Leposaviqit, Pejës, Prizrenit, Rahovecit, Shtimes dhe Vushtrrisë, të kujdesen që nuk iniciojnë aktivitete për punë të cilat nuk janë të planifikuara.
- Komunat të kujdesen se planifikojnë mirë aktivitetet për furnizim, shërbime dhe punë në mënyrë që detajet e paraqitura në plan të prokurimit të jenë të njëjta edhe gjatë inicimit të aktivitetit.
- KRPP si organ përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, të sqaroj se në cilat rrethana dhe në bazë të cilave kushte AK-të mund ta ndryshojnë planin përfundimtar të prokurimit.
- Njësitë kërkuese dhe ZPP-të planifikimin e prokurimit të mos e shohin si përgjegjësi të ndarë. Bashkëpunimi në mes tyre është i domosdoshëm dhe atë jo vetëm gjatë fazës së planifikimit por edhe gjatë fazës së zbatimit të planit të prokurimit.
- Njësitë kërkuese dhe ZPP-të të kenë të qartë se vendosja e artikullit, sasisë dhe njësisë tek aktivitetet për furnizim është obligim ligjor, dhe mos vendosja e tyre përveç që është mos zbatim i ligjit në të njëjtën kohë e devijon planifikimin e mirëfilltë të furnizimeve për nevojat e komunës dhe qytetarëve.
- Autoritetet kontraktuese të sigurohen se planin e prokurimit të kenë në përputhje me nevojat dhe kapacitetet buxhetore të tyre. Nëse kjo nuk merret parasysh atëherë plani i prokurimit është vështirë i zbatueshëm.
- Autoritetet kontraktuese dukurinë e rritjes së çmimeve, përkatësisht vlerësimin e tregut të marrin parasysh gjatë procesit të planifikimit, në të kundërtën plani i prokurimit mbetet i pa zbatueshëm, si dhe rrezikohet cilësia e shërbimeve eventuale.

- Kryetarët e komunave të shqyrtojnë me seriozitet mundësitë për dërgimin e trajnime shtesë të zyrtarëve komunalë për të ngritur kapacitetet e tyre profesionale lidhur me ciklin e planifikimit të prokurimit dhe mjeteve tjera në dispozicion për planifikim cilësor që përmbushë objektivat institucional.
- Komunat të sigurohen se nënshkruajnë kontrata për punë shtesë vetëm lidhur me arsyet e parapara me ligj, në rastet tjera konsiderohet keqpërdorim i mundësisë ligjore për punë shtesë.

## 15. Aneks I: Pesë (5) aktivitetet e para për furnizime, shërbime dhe punë të monitoruara në njëzet (20) komuna

KOMUNA E DEÇANIT							
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2022							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €
1.	Furnizim me material zyrtarë për institucionet publike të Komunës së Deçanit <i>Numri i prokurimit: 631-22-2408-1-2-1</i>	I	Komplet	120,000.00	155 8 18 2 2 1	Copë m <sup>2</sup> Bllok Komplet Pako Risa	120,000.00
2.	Furnizimi dhe montimi i nxemjes qendrore në QMF Irzniq <i>Numri i prokurimit: 631-22-4043-1-2-1</i>	N/A <sup>32</sup>	N/A	N/A	26 150 249 1	Copë L m Komplet	12,000.00
3.	Furnizim me material zyrtarë për institucionet publike të Komunës së Deçanit-LETET <i>Numri i prokurimit: 631-22-4648-1-3-6</i>	I	Komplet	120,000.00	1160	Risa	5,000.00
4.	Furnizim me material Laboratorik <i>Numri i prokurimit: 631-22-4714-1-2-1</i>	I	Komplet	99,800.00	90785 3365 13	Copë Pako L	90,000.00
5.	Furnizim me material stomatologjik dhe shpenzues për QKMF" Adem Ukëhaxhaj" Deçan <i>Numri i prokurimit: 631-22-4775-1-2-1</i>	I	Komplet	50,000.00	16905 903 1110 195 100	Copë Pako L Scatul Kg	40,000.00
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2022							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €			Inicim/Vlera €		
1.	Zerimi për manifestime të ndryshme në Deçan <i>Numri i prokurimit: 631-22-1730-2-3-6</i>				9,900.00	9,900.00	
2.	Shërbim me tenda dhe karrika për manifestime <i>Numri i prokurimit: 631-22-3070-2-3-6</i>				9,900.00	9,900.00	
3.	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në Komunën e Deçanit <i>Numri i prokurimit: 631-22-6182-2-1-1</i>				N/A	1,887,120.00	
4.	Transporti dhe qëndrimi në Durrës për stafin e Shtëpisë së komunitetit <i>Numri i prokurimit: 631-22-6402-2-3-6</i>				3,000.00	3,000.00	
5.	NA						
Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2022							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €			Inicim/Vlera €		
1.	Meremetimi dhe inventarizimi i objektit shtëpia alpine bjeshkatore Shkëlzen Haradinaj Deçan <i>Numri i prokurimit: 631-22-2164-5-2-1</i>				100,000.00	387,727.00	
2.	Ndërtimi i fshatit turistik Podi i Gështenjave <i>Numri i prokurimit: 631-22-3403-5-2-1</i>				200,000.00	250,000.00	
3.	Ndërtimi i qendrës turistike në bashkëfinancim me IPA, GIZ dhe EU <i>Numri i prokurimit: 631-22-3915-5-2-1</i>				N/A	172,000.00	
4.	Elektrifikimi i bjeshkës së Belegut <i>Numri i prokurimit: 631-22-4854-5-2-1</i>				100,000.00	350,000.00	
5.	Ndërtimi i rrugës në fshatin Pleqe <i>Numri i prokurimit: 631-22-5779-5-1-1</i>				200,000.00	699,970.00	
KOMUNA E DRAGASHIT							
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2022							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €
1.	Furnizim me dru (ahu, bungu) për ngrohje dhe sharritja e tyre për nevojat e Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2022 (procedura negociuar) (V=200mH)	/ <sup>33</sup>	/	99,360.00	200 mH	m <sup>2</sup>	8,000.00

<sup>32</sup> **Sqarim:** (N/A) në të gjitha rastet në Aneks I nënkupton se aktiviteti nuk figuron fare në planin përfundimtar të prokurimit.

<sup>33</sup> **Sqarim:** shenja (/) në të gjitha rastet në Aneks I nënkupton se mungon detaji i caktuar.



	Numri i prokurimit: 621-22-622-1-3-5						
2.	Furnizimi dhe servisi me aparate te zjarrrfiksave per te gjitha institucionet e K.K. Dragash Numri i prokurimit: 621-22-2658-1-3-6	NA	NA	NA	121	Copë	2,500.00
3.	Furnizimi me material shpenzues laboratorik – për Q.K.M.F. Dragash •LOT-1 – Furnizimi me material shpenzues laboratorik • LOT-2 – Furnizimi me material shpenzues laboratorik Numri i prokurimit: 621-22-2655-1-2-1	/	/	70,000.00	2800 18 1592 47,300	Test L MI Copë	14,000.00
4.	Furnizimi, çmontimi, montimi dhe balansimi i gomave verore për automjetet e K.K Dragash Numri i prokurimit: 621-22-3325-1-3-6	NA	NA	NA	90	Copë	9,800.00
5.	Furnizimi me oxygen O2 per nevojat e QKMF -se dhe veturat e QKMF-se ne K.K. Dragash Numri i prokurimit: 621-22-4554-1-3-6	NA	NA	NA	2000 18	L Copë	3,500.00
<b>Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2022</b>							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €			Inicim/Vlera €		
1.	Dezinsektimi, deratizimi dhe dezinfektimi te Drejtoratit te Shendetesise – Dragash – per Q.K.M.F., Q.M.F. ade A.M.F.-te Numri i prokurimit: 621-22-2331-2-3-6	NA			1,500.00		
2.	Shërbimet e varrimit në teritorin e Komunës se Dragashit – (12 muaj) (procedur e negociuar) - RITENDERIM Numri i prokurimit: 621-22-2323-2-2-5	66,000.00			65,000.00		
3.	Servisimi i paisjeve laboratorike ne Q.K.M.F. "Adem Berisha" Dragash dhe laboratorit i Q.M.F.-se ne Krushev, Bellobrad, Brodosane Numri i prokurimit: 621-22-2917-2-3-6	3,200.00			3,400.00		
4.	Renovimi i shkollës fillore "SVETLOST" në Krushevë - Dragash Numri i prokurimit: 621-22-4524-2-3-6	20,000.00			2,200.00		
5.	Renovimi i hapësirave dhe meremetimi i nënkulmit te shkollës SH.F.M.U "Ilmi Bahtijari" në fshatin Blaç – K.K. Dragash Numri i prokurimit: 621-22-6435-2-3-6	N/A			7,000.00		
<b>Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2022</b>							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €			Inicim/Vlera €		
1.	Rregullimi i murit mbrojtës në rrugën Brrut-Zgatar Numri i prokurimit: 621-22-929-5-2-1	39,661.00			39,661.00		
2.	Kubëzimi i rrugëve dhe rregullimi i infrastrukturës në fshatin Dikancë Numri i prokurimit: 621-22-839-5-2-1	15,000.00			15,000.00		
3.	Ndërtimi i rrugës Bjeshkë-Kosavë Numri i prokurimit: 621-22-1632-5-2-1	15,000.00			15,000.00		
4.	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Buqe Numri i prokurimit: 621-22-1601-5-2-1	20,000.00			20,000.00		
5.	Rregullimi i urës te mulliri I Azizit në fshatin Brrut Numri i prokurimit: 621-22-1547-5-2-1	20,000.00			20,000.00		
<b>KOMUNA E FERIZAJT</b>							
<b>Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2022</b>							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €
1.	Furnizim me material hargues per laborator per nevojat e QKMF-se Numri i prokurimit: 656-22-152-1-2-1	/	/	34,584.00	2367 1,111,488 5	Pako Copë L	105,000.00
2.	Përmirësimi i kushteve dhe përfomancës për grupmohën (3-6 vjeç) në Sh.F.M.U. Naim Frashëri, Zaskok Numri i prokurimit: 656-22-286-1-3-6	NA	NA	NA	103	Copë	5,000.00
3.	Furnizim me terapi ampulare dhe infuzione per nevojat e QKMF-se Numri i prokurimit: 656-22-283-1-2-1	/	/	16,000.00	146,840	Copë	32,000.00
4.	Mbushja e bocave me oksigjen medicinal dhe furnizimi me manometra për boca të okigjenit për nevoja të QKMF-së Ferizaj. Numri i prokurimit: 656-22-355-1-3-6	/	/	1,500.00	1000 15	Kg Copë	1,500.00
5.	Furnizim me dru per administratën komunale, shkolla dhe institucione tjera qe funksionojne ne kuader te Komunes se Ferizajt Numri i prokurimit: 656-22-351-1-1-1	/	/	227,300.00	5580	mH	240,000.00
<b>Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2022</b>							

Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €	Inicim/Vlera €				
1.	Sigurimi fizik i objektit të Komunës së Ferizajt dhe Institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Ferizajt <i>Numri i prokurimit: 656-22-116-2-2-5</i>	542,605.00	99,091.77				
2.	Permiresimi i shërbimeve përmes uljeve të shpenzimeve në sektorin e shërbimeve të Komunës <i>Numri i prokurimit: 656-22-259-2-2-1</i>	NA	35,000.00				
3.	Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e hapsirave publike <i>Numri i prokurimit: 656-22-445-2-2-1</i>	10,000.00	10,000.00				
4.	"Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objektit të Komunës së Ferizajt dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Ferizajt" <i>Numri i prokurimit: 656-22-487-2-1-1</i>	252,516.00	252,516.00				
5.	Regjistrimi i automjeteve të Administratës komunale, QKMF-së dhe BZ-Ferizaj <i>Numri i prokurimit: 656-22-2059-2-2-1</i>	26,000.00	26,000.00				
<b>Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2022</b>							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €	Inicim/Vlera €				
1.	Rikonstruimi i rrugës Ahmet Kaçiku - projekt tre vjeçar <i>Numri i prokurimit: 656-22-251-5-2-1</i>	200,000.00	200,000.00				
2.	Rregullimi i kanalizimit fekal dhe i rrugëve në Lagjën Mehaj, fsh. Dremajk-projekt trevjeçar <i>Numri i prokurimit: 656-22-395-5-2-1</i>	180,000.00	180,000.00				
3.	Rregullimi teknik i trafikut dhe sinjalizimi- shenjat ndriçuese <i>Numri i prokurimit: 656-22-786-5-2-1</i>	25,000.00	25,000.00				
4.	Ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore dhe rrugëve të mbetura në Komogllave - faza II <i>Numri i prokurimit: 656-22-778-5-2-1</i>	280,000.00	919,980.00				
5.	Asfaltimi i rrugicave në Bablak dhe rrugicave të mbetura në fshatin Terrn dhe Prelez i Jerlive - Faza II - projekt dy vjeçar <i>Numri i prokurimit: 656-22-829-5-2-1</i>	589,000.00	220,000.00				
<b>KOMUNA E GLOGOCIT</b>							
<b>Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2022</b>							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €
1.	Lot I - Furnizim me buqeta lulesh të freskta për homazhe dhe aktivitete të tjera, Lot II-Furnizim me kurora dhe buqeta lulesh, flamuj me shtiza të flamujve <i>Numri i prokurimit: 611-22-473-1-2-1</i>	1,00	Copë	3,000.00	3454	Copë	18,994.00
2.	Blerja e kontejnerëve për mbeturina <i>Numri i prokurimit: 611-22-1597-1-2-1</i>	1,00	Copë	20,000.00	2	Copë	20,000.00
3.	Furnizim me artikuj 1 material elektrik, vegllari dhe llaqe, 2. Artikuj të sanitarisë dhe 3. Artikuj bujqësorë. - për nevojat e institucioneve komunale <i>Numri i prokurimit: 611-22-1452-1-1-1</i>	NA	NA	NA	36,871 7833 1573 120 300 1896 112 45	Copë m Kg Tuba Thasë L Palë Pako	175,256.25
4.	Punimi i mbishkrimit të emrit të shkollave <i>Numri i prokurimit: 611-22-2467-1-3-6</i>	1,00	Copë	3,000.00	6	Copë	6,171.06
5.	Furnizimi i shkollave me kabinete për kimi, fizikë dhe biologji <i>Numri i prokurimit: 611-22-2595-1-2-1</i>	1,00	Copë	50,000.00	205	Copë	50,000.00
<b>Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2022</b>							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €	Inicim/Vlera €				
1.	Dekorimi i qytetit për festa shtetërore dhe kombëtare për vitin 2022-2023 <i>Numri i prokurimit: 611-22-100-2-2-1</i>	15,000.00	15,020.00				
2.	Shërbime konsulente për nevojat e Komunës së Drenasit <i>Numri i prokurimit: 611-22-157-2-3-6</i>	NA	9,000.00				
3.	Mirëmbajtja dhe servisi i pajisjeve radiologjike në QKMF <i>Numri i prokurimit: 611-22-203-2-2-1</i>	NA	36,000.00				
4.	Gjelbrimi i hapsirave publike <i>Numri i prokurimit: 611-22-284-2-2-1</i>	NA	60,000.00				

5.	Transporti i nxensve per arsim dhe aftesim profesional - praktikat profesionale dhe transporti brenda dhe jashte vendi per aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore Numri i prokurimit: 611-22-820-2-2-1	NA	65,340.00				
<b>Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2022</b>							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €	Inicim/Vlera €				
1.	Instalimi i ndriqimit te ri dhe riparimi i rrjetit të ndriqimit publik ekzistues në Komunën e Drenasit Numri i prokurimit: 611-22-98-5-2-1	30,000.00	90,000.00				
2.	Mirembajtja e deponis Inerte Numri i prokurimit: 611-22-293-5-2-1	NA	35,000.00				
3.	Renovimi dhe mirembajtja e objektit te SHZSH Numri i prokurimit: 611-22-813-5-3-6	4,999.98	5,000.00				
4.	Rregullimi dhe zgjerimi i vendndaljeve per autobus dhe mbulimi i tyre Numri i prokurimit: 611-22-2355-5-2-1	30,000.00	30,000.00				
5.	Pastrimi i deponive te egra Numri i prokurimit: 611-22-2537-5-2-1	NA	30,000.00				
<b>KOMUNA E GJAKOVES</b>							
<b>Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2022</b>							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €
1.	Furnizim me libra për Bibliotekën Publike Ibrahim Rugova Numri i prokurimit: 632-22-1908-1-3-6	N/A	N/A	5,000.00	114	Copë	1,999.60
2.	Furnizim me material për realizimin e skenografisë dhe kostumografisë Numri i prokurimit: 632-22-2262-1-2-1	N/A	N/A	11,000.00	226 1198 252 6 10 38	Copë m L Komplet Set Kg	11,000.00
3.	Furnizim me uniforma Numri i prokurimit: 632-22-3489-1-2-1	N/A	N/A	20,300.00	1434	Copë	17,917.00
4.	Furnizimi, montimi dhe ndërtimi me material për klasën verore në SHFMU "Ukshin Miftari" Numri i prokurimit: 632-22-3675-1-3-6	N/A	N/A	N/A	250 75 100 50	Copë Kg m <sup>2</sup> L	2,984.00
5.	Furnizim me material zyrtar dhe paisje projekti Art dhe Kulturë SHFMU" Z. L. Marku" Numri i prokurimit: 632-22-4197-1-3-6	N/A	N/A	N/A	893 30	Copë Pako	1,500.00
<b>Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2022</b>							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €	Inicim/Vlera €				
1.	Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme Numri i prokurimit: 632-22-1037-2-2-1	371,000.00	21,726.00				
2.	Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale Numri i prokurimit: 632-22-880-2-2-5	240,000.00	60,000.00				
3.	Shërbime të telefonisë mobile - Kontratë tre vjeçare Numri i prokurimit: 632-22-2113-2-2-1	50,400.00	60,000.00				
4.	Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare Numri i prokurimit: 632-22-4656-2-2-1	29,100.00	29,100.00				
5.	Molerimi i shkollave Numri i prokurimit: 632-22-4839-2-2-1	50,000.00	50,000.00				
<b>Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2022</b>							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €	Inicim/Vlera €				
1.	Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Fshaj, Marmull, Kushavec Numri i prokurimit: 632-22-4114-5-2-1	150,000.00	149,996.50				
2.	Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatin Gërçinë Numri i prokurimit: 632-22-4270-5-2-1	150,000.00	146,402.42				
3.	Ndërtimi dhe sanimi i parqeve Numri i prokurimit: 632-22-4421-5-2-1	250,000.00	250,000.00				
4.	Renovimi i nyjeve sanitare në shkollat e Gjakovës Numri i prokurimit: 632-22-4727-5-2-1	140,000.00	139,975.00				
5.	Ndërtimi i qerdhës në Dardani Numri i prokurimit: 632-22-4855-5-2-1	300,000.00	245,692.11				

KOMUNA E GJILANIT							
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2022							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €
1.	Furnizim me farë misri Numri i prokurimit: 651-22-1634-1-2-1	1	N/A	25,000.00	1000	Thes	25,000.00
2.	Furnizim me ushqim të kafshëve (sanë), koncentrat dhe kontrollë mjekësore Numri i prokurimit: 651-22-2097-1-2-1	1	N/A	85,482.00	19700 65700 1	Copë Kg Paushallë	85,482.00
3.	Furnizim me makinë për larjen e rrobave Numri i prokurimit: 651-22-3353-1-2-1	1	N/A	15,000.00	2	Copë	15,000.00
4.	Furnizim me pemë dhe perime për çerdhet dhe konviktin Numri i prokurimit: 651-22-2142-5-5-8	N/A	N/A	N/A	6,756 50 50	Kg Copë Pako	7,162.00
5.	Furnizim me letër për Komunën e Gjilanit Numri i prokurimit: 651-22-3762-1-3-6	N/A	N/A	N/A	2800	Rise	9,999.99
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2022							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €		Inicim/Vlera €			
1.	Pastrimi i Objekteve Shkollore Numri i prokurimit: 651-22-985-2-1-1	500,743.00		500,743.00			
2.	Shërbime Konsulente të individuale për nevoja të Komunës së Gjilanit Numri i prokurimit: 651-22-2711-2-1-1	242,388.00		211,116.00			
3.	Dezinsektimi hapsinor, Dezinsektim dhe Deratizim i objekteve në Komunën e Gjilanit Numri i prokurimit: 651-22-1970-2-1-1	135,000.00		172,000.00			
4.	Hartimi i planit komunal të veprimit për energji dhe klimë Numri i prokurimit: 651-22-3993-2-2-1	N/A		20,000.00			
5.	Furnizim me 30 paisje GPS-a për monitorimin e lëvizjes së automjeteve të Komunës së Gjilanit dhe mirëmbajtja e tyre Numri i prokurimit: 651-22-3359-2-3-6	2,500.00		6,900.00			
Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2022							
